

VENDIM
Nr. 148, datë 10.3.2021

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE DURRËS DHE RROGOZHINË TË
OBJEKTEVE ARSIMORE, SHKOLLA 9-VJEÇARE “NEIM BABAMETO”, BASHKIA
DURRËS, DHE SHKOLLA 9-VJEÇARE “GOSË”, BASHKIA RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkive Durrës dhe Rrogozhinë, përkatësisht, të objekteve arsimore shkolla 9-vjeçare “Neim Babameto”, Bashkia Durrës, dhe shkolla 9-vjeçare “Gosë”, Bashkia Rrogozhinë, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Durrës e Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e Ndërhyrjes	Financimi i Ndërtimit	Sipërfaqe (m ²)	Vlera e Projekt Idesë	Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e Mbikëqyrjes	Vlera e koaludimit	Vlera totale e objektit
1	Durrës	Durrës	Durrës	9-vjecare	Neim Babameto	Rindërtim	Buxhet GoA	5,324.0	2,516,540.40	224,500,000.00	1,833,873.00	213,127.42	229,063,540.82
2	Tiranë	Rrogozhinë	Gosë	9-vjecare	Gosë	Rindërtim	Buxhet GoA	3,200.0	1,263,489.20	110,100,100.00	1,152,685.00	125,363.29	112,641,637.49